**V E N D I M**
**Nr.323, datë 8.7.1999**

# PËR PËRGATITJEN, PËRSHTATJEN DHE ZBATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE DHE PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT ME RREGULLAT TEKNIKE DHE STANDARDET

*(Ndryshuar me ligjin nr. 9097, datë 3.7.2003)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e dispozitave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:
- përgatitjen, përshtatjen dhe zbatimin e rregullave teknike;
- procedurat për vlerësimin e konformitetit nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore;
- njohjen e vlerësimit të konformitetit nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore;
- procedurat për vlerësimin e konformitetit nga organizmat joshtetërorë;
- sistemet ndërkombëtare dhe rajonale të vlerësimit të konformitetit.

2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe instituconet e tjera qendrore, sipas fushave të veprimtarisë që mbulojnë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendm hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Pandeli Majko**

## PËRGATITJA, ADOPTIMI DHE ZBATIMI I RREGULLAVE TEKNIKE

1. Terminologjia e përdorur:

1.1- Procedura e vlerësimit të konformitetit – Quhet çdo procedurë direkt ose indirekt, për të përcaktuar nëse kërkesat e dhëna në një rregull teknik ose standard, janë plotësuar.

1.2- Procedurat e vlerësimit të konformitetit përfshijnë procedurat për marrjen e mostrave, provat/analizat dhe inspektimet; vlerësimin, verifikimin dhe sigurimin e përputhjes; regjistrimin, akreditimin dhe aprovimin, si dhe kombinimet e tyre.

1.3- Organe joshtetërore – Kuptohen ato organe private të vlerësimit të konformitetit të cilave shteti iu jep të drejtën për të kryer procedurat e vlerësimit të konformitetit.

1.4- OBT - kuptohet Organizata Botërore e Tregtisë

2. Përsa u përket rregullave teknike, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që produkteve të importuara nga territori i çdo vendi anëtar i OBT-së, t'u jepet një trajtim jo më pak i favorshëm nga ai që u jepet produkteve të ngjashme me origjinë

kombëtare, si dhe produkteve të ngjashme me origjinë nga vendet e tjera.

3. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që rregullat teknike të mos përgatiten, adoptohen ose zbatohen me qëllimin, ose me pasojën, e krijimit të pengesave të panevojshme në tregtinë ndërkombëtare. Për këtë qëllim, rregullat teknike nuk duhet të jenë shumë më kufizuese ndaj tregtisë, nga ç'është e nevojshme. Një gjë e tillë bëhet për të përmbushur një objektiv të ligjshëm duke patur parasysh rreziqet që do të krijoheshin nga mospërmbushja e tij. Objektiva të tillë të ligjshëm, ndër të tjera, janë: kërkesat për sigurinë kombëtare, parandalimi i praktikave mashtruese, mbrojtja e shëndetit dhe e sigurisë së njeriut, mbrojtja e jetës ose e shëndetit të kafshëve apo të bimëve dhe ajo e mjedisit. Në vlerësimin e rreziqeve të tilla, elemente të rëndësishme për t'u patur parasysh, ndër të tjera, janë: informacioni i dobishëm shkencor e teknik, teknologjia përpunuese që lidhet me produktet apo destinacioni i parashikuar i përdorimit të tyre.

4. Rregullat teknike nuk mbahen në fuqi nëse rrethanat apo objektivat që e kanë bërë të nevojshëm miratimin e tyre nuk ekzistojnë më, ose nëse rrethanat apo objektivat e ndryshuar mund të trajtohen sipas një mënyre që është më pak kufizuese për tregtinë.

5. Në rastet kur kërkohen rregulla teknike dhe standardet ndërkombëtare përkatëse ose ekzistojnë ose përfundimi i tyre është i afërt, si bazë për rregullat e tyre teknike, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa të përdorin ose ato ose pjesë të rëndësishme të tyre, me përjashtim kur standarde të tilla ndërkombëtare ose pjesë të rëndësishme të tyre do të ishin të paefektshme ose të papërshtatshme për përmbushjen e objektivave të ligjshëm, siç janë faktorët themelorë klimaterikë ose gjeografikë, ose për shkak të problemeve themelore teknologjike.

6. Ministria ose institucioni qendror që përgatit, miraton ose zbaton një rregull teknik, që mund të ketë një efekt të ndjeshëm në tregtinë me vendet e anëtare të OBT-së, me kërkesën e një anëtari tjetër dhe në bazë të dispozitave të paragrafëve nga 2 deri ne 5, duhet të shpjegojë përligjien e atij rregulli teknik. Kur përgatitet, miratohet ose zbatohet një rregull teknik për një nga objektivat e ligjshëm të përmendur qartë në paragrafin 3 dhe kur ai është në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare, rregulli teknik duhet të lerë të kuptojë pa ekuivoke se nuk krijon asnjë pengesë të panevojshme për tregtinë ndërkombëtare.

7. Duke patur parasysh harmonizimin e rregullave teknike mbi një bazë sa më të gjerë që të jetë e mundur, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, duhet të aktivizohen plotësisht, brenda mundësive të tyre, në përgatitjen e standardeve ndërkombëtare nga organet përkatëse ndërkombëtare të standardizimit, standarde që kanë të bëjnë me produktet për të cilat ata ose kanë miratuar, ose presin të miratojnë rregulla teknike.

8. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, marrin masa për të shqyrtuar mundësinë e pranimit të rregullave teknike të vendeve anëtare të OBT-së si rregulla të barasvlershme, edhe sikur këto rregulla të ndryshojnë nga ato të tyret, por me kusht që të jenë të bindur se këto rregulla i përmbushin në mënyrë të mjaftueshme objektivat që synojnë të arrijnë me hartimin e rregullave nga ana e tyre.

9. Kur gjykohet e nevojshme, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, marrin masa për të specifikuar rregullat teknike që mbështeten te kërkesat e produktit në lidhje me funksionimin e tij dhe jo me anën përshkrimore dhe vizatimore të tij.

10. Kur nuk ekziston ndonjë standard përkatës ndërkombëtar, ose kur përmbajtja e një rregulli teknik të propozuar nuk është në përputhje me përmbajtjen teknike të standardeve përkatëse ndërkombëtare, si dhe kur ekzistojnë gjasat që rregulli teknik të

ushtrojë një efekt të ndjeshëm në tregtinë e vendeve të tjera anëtare, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore marrin masa që:

10.1 të bëjë njoftim në buletin duke lënë një kohë të mjaftueshme, në mënyrë që palët e interesuara në vendet e tjera anëtare të OBT-së, të kenë mundësi të njihen me projektin dhe të dinë se po propozohet futja në përdorim e një rregull teknik të veçantë;

10.2 të njoftojnë nëpërmjet Sekretariatit të OBT-së, anëtarët e tjerë të OBT-së se për produktet që do të mbulohen nga rregulli teknik i propozuar, duke e shoqëruar njoftimin me një shënim të shkurtër për objektivin dhe bazën ku mbështetet rregulli teknik. Këto njoftime duhet të bëhen duke lënë një kohë të mjaftueshme brenda së cilës mund të bëhen rregullime dhe vërejtjet të mund të merren parasysh;

10.3 sipas kërkesës, ministritë dhe institucionet qendrore, duhet të venë në dispozicion hollësi rreth rregullit teknik të propozuar ose kopje të tij dhe, kur është e mundur, të identifikohen pjesët që shmangen ndjeshëm nga standardet ndërkombëtare përkatëse;

10.4 ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, u lihet një kohë e arsyeshme për të bërë vërejtje me shkrim dhe për t'i diskutuar këto vërejtje, nëse një gjë e tillë u kërkohet nga vendet e tjera anëtare të OBT-së , si këto vërejtje me shkrim ashtu edhe rezultatet e diskutimeve të bëra rreth tyre, duhet të merren parasysh.

11. Në rastet kur lindin ose ka rrezik të lindin probleme urgjente për sigurinë, shëndetin, mbrojtjen e mjedisit apo sigurinë kombëtare, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, mund t'i kapërcejnë disa nga hapat e renditur në paragrafin 10, si ta gjykojne vetë të arsyeshme, me kusht që me miratimin e një rregulli ato:

11.1 do të njoftojnë menjëherë nëpërmjet Sekretariatit të OBT-së, anëtarët e tjerë të OBT-së për rregullin teknik të veçantë dhe për produktet që mbulohen prej tij, duke e shoqëruar njoftimin me një shënim të shkurtër për objektivin dhe për bazën ku mbështetet rregulli teknik, përfshirë edhe natyrën e problemeve urgjente që lidhen me të;

11.2 sipas kërkesës, anëtarëve të OBT-së duhet t'u vihen në dispozicion kopje të rregullave teknike;

11.3 anëtarëve të tjerë të OBT-së pa dallim, duhet t'u lihet një kohë e arsyeshme për t'i paraqitur vërejtjet e tyre me shkrim dhe për t'i diskutuar këto vërejtje, nëse një gjë e tillë kërkohet; nga ana tjetër, vërejtjet me shkrim, si dhe rezultatet e diskutimeve të bëra rreth tyre, duhet të merren parasysh.

12. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, marrin masa, që të gjitha rregullat teknike që miratohen ose të botohen menjëherë, ose të bëhen të disponueshme në ndonjë mënyrë tjetër për t'u mundësuar palëve të interesuara në vendet e tjera anëtare të OBT-së të njihen me to.

13. Me përjashtim të rrethanave urgjente që përmenden në paragrafin 11, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, duhet të lënë një interval të arsyeshëm kohe midis botimit të rregullave teknike dhe hyrjes së tyre në fuqi, në mënyrë që t'u jepet kohë prodhuesve të vendeve anëtare eksportuese të OBT-së dhe veçanërisht atyre të vendeve anëtare të OBT-së që konsiderohen vende në zhvillim për t'ua përshtatur produktet e tyre ose metodat e tyre të prodhimit, kërkesave të vendit anëtar të OBT-së, importues.

## PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT NGA MINISTRITË DHE INSTITUCIONET E TJERA QENDRORE

*(Shfuqizuar me ligjin nr. 9097, datë 3.7.2003)*

NJOHJA E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT NGA MINISTRITË DHE INSTITUCIONET E TJERA QËNDRORE

*(Shfuqizuar me ligjin nr. 9097, datë 3.7.2003)*

PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN E KONFORMITETIT NGA ORGANET JO SHTETRORE

*(Shfuqizuar me ligjin nr. 9097, datë 3.7.2003)*

SISTEMET NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

*(Shfuqizuar me ligjin nr. 9097, datë 3.7.2003)*